



Prishtinë, 19.11.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1456_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2243_09_21** i dt.30.09.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **18.10.2021**;

në seancën e mbajtur më datë 19.11.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si i pabazuar** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin I.L me shifër DPE – 123138.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2243_09_21, i datës 30.09.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 30.09.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2243_09_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit I.L dhe e ka obliguar KESCO-n që ta anulojë faturën e dt. 01.08.2019 dhe për këtë periudhë ta faturoj me TL = 498 kWh dhe TU = 158 kWh, kurse për periudhën 06/2019 me TL = 719 kWh dhe TU = 191 kWh.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi për periudhën 07/2019 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruar në njehsorin nr. 63945894, dhe se ZRrE vendimin e saj e arsyeton në krahasimin e shpenzimeve, por që krahasimi i shpenzimeve në periudha të caktuara nuk është fakt i vetëm dhe real, nëse njehsori ka bërë matje të saktë ose jo.
- Në asnjë rast nuk është dëshmuar që është dëmtuar kabli i furnizues nga ekipet e KEDS-it, ashtu siç pretendon konsumatori.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2243_09_21 i datës 30.09.2021 për konsumatorin I.L.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.



Në pretendimin se faturimi për periudhën 07/2019 është i saktë, ZRrE thekson se si i tillë, nuk qëndron, për faktin se, fillimisht, me datë 16.07.2019 punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë inspektuar pikën matëse dhe me kërkesë të konsumatorit është ndërruar njehsori. Konsumatori ka ofruar fotografi me të cilat vërtetohet se në momentin e ndërrimit të njehsorit nr. 63945894 njeri përçues është dëmtuar shtresa(izolimi). ZRrE ka analizuar procesverbalin dhe konstaton se ekipet e KEDS-it nuk kanë evidentuar asnjë dëmtim në lidhjet fizike të kablllove. Ekipi i KEDS-it ka bërë një përshkrim në procesverbal e i cili është komplet i pakuptueshëm.

Duke u bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike si dhe të listave të leximit, ZRrE ka gjetur se, konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, dhe se është vënë re që, vetëm në periudhën 06/2019, para ndërrimit të njehsorit është faturuar pa matje, vetëm me taksë dhe me asnjë procesverbal nuk është sqaruar arsyeja e mos evidentimit të shpenzimeve mujore.

Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhën kontestuese konstatohet se faturimi i shpenzimit për një muaj të vetëm periudha 07/2019 prej **19,641 kWh** nuk mund të paraqet shpenzim real të konsumatorit e që kjo vërtetohet edhe me shpenzimet energjisë elektrike të regjistruara për periudha të njëjta kohore, të me hershme si dhe të me vonshme ku: periudha 07/2016 është **741 kWh/muaj**, periudha 07/2017 është **844 kWh/muaj**, periudha 07/2018 është **777 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri nr. 20025729 për periudha të me vonshme: periudha 07/2020 është **924 kWh/muaj** dhe periudha 07/2021 është **845 kWh/muaj**.

Pra, siç edhe mund të shihet nga krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, shpenzimet e regjistruara janë dukshëm më të vogla, andaj, me asnjë argument nuk mund të vërtetohet që ky shpenzim i faturuar nga KESCO paraqet shpenzim real të konsumatorit.

Po ashtu, Bordi ka analizuar edhe faturën e dt. 01.08.2019 me 19,641 kWh si edhe procesverbalin e dt. 16.07.2019 të ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik, dhe ka gjetur se në procesverbal nuk janë evidentuar dëmtimet e përçuesve, por që është bërë një përshkrim në procesverbal, i cili është komplet i pakuptueshëm. Andaj, Bordi i ZRrE-së, thekson se, shkalla e parë në ZRrE (DMK), me të drejtë ka vlerësuar se konsumatori duhet të lirohet nga kjo faturë, pasi që ky shpenzim nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit.

Konsumatori në ankesën e tij thekson se ka njoftuar KEDS-in lidhur me rritjen e shpenzimeve si pasojë e mos matjes së saktë të njehsorit elektrik nr. 63945894 dhe se ekipi i KEDS-it në momentin e largimit të njehsorit nga matja kanë evidentuar se njëra kabull ka qenë e dëmtuar përkatësisht me rastin e ndërrimit të njehsorit nr. 10496079 dhe vendosjes së njehsorit nr. 63945894 përçuesit kanë qenë të shtrënguar dhe se për këtë shkak njërit përçues i është dëmtuar shtresa(izolimi) me ç'rast ka prekur në llamarinë dhe ka humbur energjia. Po ashtu Konsumatori ka bashkëngjitur dy foto me të cilat vërtetohet se njeri përçues ka qenë i dëmtuar.

Duke u bazuar në nenin 28, par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në të cilën parashihet si vijon: *"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e*



lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”, ZRRE thekson se, konsumatori është i obliguar që të paguaj për energjinë elektrike të shfrytëzuar, sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo, në asnjë formë, konsumatori nuk duhet të ngarkohet me shpenzime të cilat qartazi nuk janë reale dhe nuk përkojnë me shpenzimet e zakonshme të konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit I.L,
- Arkivit të ZRRE-së